



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.3026/2 prot.

Datë 23.10.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Erzeni/SH” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-13585-07-18-2024, me objekt: “Loti I “Blerje pajisje mobilimi për shtëpizat e mbështetura burra dhe gra” për Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë” me fond limit 33,397,648.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “KLAME” SHPK me NIPT K21518003F dhe adresë: Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.  
Blv: “Deshmoret e Kombit” nr.3, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Erzeni/SH” SHPK me NIPT J66902027T dhe adresë: Lagjja Bahçallek, Rruga Nacionale Shkoder-Tirane, nr pasurie 17/910, zona kadastrale 8591, Shkodër.

Në datën 21.10.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4681 si dhe nr. Protokolli 3026/2024 datë 22.10.2024 i operatorit ekonomik “KLAME” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-13585-07-18-2024, me objekt: “Loti I “Blerje pajisje mobilimi për shtëpizat e mbështetura burra dhe gra” për Drejtorinë e Spitalit Psikiatrik “Ali

Mihali” Vlorë” me fond limit 33,397,648.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të vlereësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Erzeni/SH” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit,

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime**”.

Lidhur me operatorin ekonomik “Erzeni/SH” SHPK, ankimuesi pretendon si me poshte:

“[...]

*Bazuar ne arsyetimin dhe faktet e paraqitura, gjykojme se nga ana e shoqerise se kualifikuar e para, oferta e te cilit ne zbatim te formules se percaktuar ne legjislacion ka dale anomalisht e ulet, nuk eshte arritur qe te argumentohet, duke mos krijuar bindjen se kjo oferte eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj, me qellim garantimin e nje kontrate te suksesshme.*

*Rrjedhimisht gjykojm, se nga ana e ketij operatori ekonomik, nuk eshte paraqitur argumentimi i ofertes anomalisht te ulet ne perputhje me nenin 93 pika 2 te LPP-se, ndaj oferta e tij duhet te skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor”.*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 23.10.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**